




Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština štrpcë

Komuna e Shterpçës

Municipality of Strpce



Në mbështetje të nenit 12, 17, 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shterpçës Nr. 01- 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shterpçës në mbledhjen e mbajtur më datën 29/02/2024 miratoi këtë :

V E N D I M

Miraton procesverbal nga seanca e kuvendit e mbajtur me 26.01.2024

1. Miratohet procesverbal nga seanca e kaluar e Kuvendit i Komunës sipas tekstit e dhënë në këtë vendim.
2. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryesuesit te Kuvendit Komunal .

Kryesuesi i Kuvendit

Predrag Grbic





Република Косово – Republika e Kosovës - Republic of Kosovo



Општина Штрпце
Komuna e Shtërpçës
Municipality of Strpce

PROCESVERBAL

Nga seanca e parë e rregullt e KK-së së Shtërpçës, e mbajtur më 26 janar 2024. duke filluar nga ora 10:00.

Rendi dites:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e mbajtur më 27.11.2023. vjet.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar e KK së Shtërpçës.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës për zyrën e prokurimit për vitin 2024.
5. Raporti i Kryetarit të Kuvendit për zbatimin e Planit të Punës për vitin 2023.
6. Të ndryshme

Kryetari i Kuvendit, z. Grbiq hapi seancën e 1 të rregullt të KK të Shtërpçës, ku konstatoi se të pranishëm ishin 14 këshilltarë dhe se ka kuorum për mbajtjen e seancës. Më pas kaloi në pikën e 1 të rendit të ditës, pasi askush nuk foli, u hodh në votim dhe u miratua me:

13 vota për , 1 nuk votua

Pastaj kaloi në procesverbal nga seanca e kaluar, askush nuk u lajmroj përfjal dhe u miratua me 13 vota për , 1 abstenim.

Më pas në rend dite ka hyrë procesverbal nga Kuvendi i mbajtur më 27.11.2023. ai është:

Miratuar me 13 vota për 1 abstenim

Pika tjetër ishte:

Krunislav Zdravkovic, shef i zyrës së prokurimit, shkurtimisht shpjegoi procedurën e krijuimit të këtij plani, duke thënë se është duke u krijuar sipas ligjit për prokurim publik dhe sipas buxhetit të miratuar të komunës së Shtërpçës. Ai më tej tha se plani është i ndarë në tri grupe, ku i pari

është prokurimi i mallrave, i dyti është ofrimi i shërbimeve dhe grapi i tretë është për projekte kapitale dhe ka theksuar se është i gatshëm të përgjigjet në disa pyetje. nëse ka ndonjë. Meqenëse askush nuk foli, u hodh në votim.

Ai u miratua me 12 vota për , 1 kundër dhe 1 abstenim

Pika tjetër ishte:

4. Raporti i Kryesuesit të Kuvendit për zbatimin e Planit të Punës për vitin 2023.

Kryesuesi theksoi se në bazë të ligjit për transparencë, Kuvendi është i obliguar që në seancën e parë të këtij viti ta informojë Kuvendin për zbatimin e planit për vitin e ardhshëm. Ai theksoi se Kuvendi ka zbatuar të gjitha pikat e rendit të ditës të parapara në planin e punës së Kuvendit për vitin paraprak, si dhe pikat që ishin në rend dite dhe të cilat nuk ishin të parapara në planin e punës.

Duke folur për praninë e këshilltarëve në seanca, ai tha se ka një këshilltar ka munguar në gjithsej tri seancat e Kuvendit vitin e kaluar, duke theksuar më tej se prania e kryetarit në seanca ka qenë jashtëzakonisht e rëndësishme për punën e kuvendit dhe se në këtë mënyrë jemi informuar për gjithçka që po ndodh në komunën tonë, ku jemi njohur edhe me problemet që kemi pasur, si dhe me planet që është dashur të kemi në periudhën e ardhshme. Ai po ashtu tha se në bazë të informacioneve të marra nga kryetari i komunës mund të merret një pasqyrë më reale e gjithçkaje që po ndodh në komunën tonë dhe kështu të marrim vendime më të mira gjatë votimit.

Pas kësaj, kryesuesii lexoi me radhë pikat e miratuara gjatë vitit të kaluar, me të cilat këshilltarët mund të njiheshin pasi i kishin marrë me shkrim.

Meqenëse kjo pikë nuk është votuar, kaloi në pikën e fundit të rendit të ditës, që është pika:

5. Të ndryshme

Në fund të seancës, kryetari i Shtërpcës ka shfrytëzuar rastin që edhe një herë t'iu drejtohet këshilltarëve dhe mbarë opinionit për një çështje që e shqetëson prej kohësh. Në radhë të parë është raporti i institucioneve të pushtetit qendoror ndaj qytetarëve të Shtërpcës, Komunës dhe Kuvendit të Shtërpcës, megjithatë kjo ngre shqetësimë edhe më të mëdha për qendren e skijimit Sharri.

Sic tha kryetari i komunës, situata nuk është aspak e mirë në bisedat e tij të përditshme me punëtorët e qendrës së skijimit. Gjegjësisht, së fundmi me një komunikatë për media e kemi informuar opinionin për takimet dhe qëndrimet e mbajtura nga menaxhmenti i Komunës lidhur me ngjarjet në qendrën e skijimit. Mirëpo, kryetari ka dashur t'i drejtohet Kuvendit dhe t'i ftojë ata që aktualisht menaxhojnë qendrën e skijimit, "që t'i kushtojnë vëmendje asaj që po bëjnë dhe të mos mendojnë se një ditë nuk do t'u përgjigjen pyetjeve që do t'u bëhen.

"Qendra e skijimit në Brezovicë, për bindjen time të thellë, është burim për qytetarët e Komunës së Shtërpçës, punëtorët që kanë qenë në atë qendër skijimi me dekada dhe duhet të mbrohen interesat e qytetarëve të komunës së Shtërpçës dhe të punëtorëve., dhe ne do të përdorim të gjitha mjetet ligjore dhe demokratike për të luftuar që ajo e drejtë themelore që ekziston në të gjitha shoqëritë demokratike dhe që është e drejta e pronës, të mbrohet. Partitë politike shkojnë e vijnë, por këto gjëra mbeten gjithmonë", tha z. Jevtic.

Më pas Z. Grbic mbylli seancën e parë të rregullt të K K të Shtërpçës në vitin 2024.

Procesmbajtes
Staja Markovic



Kryesuesi kuvendit
Predrag Grbic